



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Planit rregullues "Lakërishta" i miratuar në bazë të Vendimit, nr. 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit rregullues "Lakërishta" dhe PZHU, nr. 04-350/01-151476/20, dt. 03.09.2020, në Prishtinë, Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-14932/21, dt. 12.03.2021, Vendim për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/03-65187/21, dt. 21.04.2021, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, PSH "Ujërat" Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi, PSH, BVI për Banim.
- II. Prona e paluajtshme komunale, PSH, "Ujërat", KK Prishtinë, që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës kadastrale nr. 07773-1, me sip. 694m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07773-1, Zona kadastrale Prishtinë, të cilat gjenden në kuadër të bllokut urban "A2", tërësia "A", të Planit rregullues "Lakërishta" i miratuar në bazë të Vendimit, 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit rregullues "Lakërishta" dhe PZHU, nr. 04-350/01-151476/20, dt.03.09.2020, në Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është parcela kadastrale nr. 10392-3, sip. 694m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-10392-3, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi PSH, BVI për Banim, në të cilën është planifikuar rrjedha e lumit, sipas planit rregullues "Lakërishtë" Prishtinë.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Lakërishta" në Prishtinë, i miratuar në bazë të Vendimit nr. 01, nr. 035-181427, dt.24.09.2013, në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesve të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtorja e Urbanizmit në bazë të Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-14932/21, dt. 12.03.2021, Vendimit për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore, nr. 05, nr.350/03-65187/21, dt. 21.04.2021, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale, nr.7773-1, sip. 694m², ZK Prishtinë, në pronësi PSH “Ujërat”, të Komunës së Prishtinës, të cilast gjenden në kuadër të bllokut urban “A2”, tërësia “A”, të Planit rregullues “Lakërishta”, i miratuar në bazë të Vendimit 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit rregullues “Lakërishta” dhe PZHU me nr. 04-350/01-151476/20, dt. 03.09.2020, në Prishtinë. Pjesa e parcelës nr. 10392-3, me sip.694m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi PSH, BVI për Banim në të cilën është planifikuar rrjedha e lumit, sipas Planit rregullues “Lakërishta” Prishtinë.

Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Lakërishta” i miratuar në bazë të Vendimit 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit rregullues “Lakërishta” dhe PZHU, me nr. 04-350/01-151476/20, dt. 03.09.2020, në Prishtinë, Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-14932/21, dt. 12.03.2021, Vendim për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/03-65187/21, dt. 21.04.2021. Pjesa e **parcelës nr. 7773-1, Zona kadastrale Prishtinë**, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa pjesa e **parcelës, nr. 10392-3 Zona kadastrale, Prishtinë**, shtrihen në infrastrukturë publike, rrjedha e lumit - rrugë të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112394/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

